



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:140465
Datë: 11.02.2025
Numri i dokumentit: 06833177

PAKR.nr.6/24

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për Krime të Rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët Xhevdet Abazi kryetar i kolegjit, Valbona Musliu - Selimaj dhe Beqir Kalludra anëtarë të kolegjit, me bashkëpunëtorin profesional Behar Haliti, në çështjen penale kundër të akuzuarit A. K. për shkak veprës penale të ri cilësuar pas përfundimit gjyqësor, nga vepra penale Vrasje në tentativë, nga neni 172 lidhur me nenin 28 të KPRK-së në veprën penale, Kanosja nga neni 181 par. 4 të KPRK-së, veprës penale, Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPRK-së, si dhe veprës penale, Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 366 par. 1 të KPRK-së, duke vendosur sipas ankesës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë dhe ankesës së mbrojtësit të akuzuarit A. K., Av. Xhevdet Smakiqi të ushtruara kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.263/2023, të datës 29.11.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur komfor nenit 390 të KPPK-së, me datë 16.01.2025 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. Me aprovimin e pjesshëm të ankesës së mbrojtësit të akuzuarit A. K., Av. Xhevdet Smakiqi, e sipas detyrës zyrtare, NDRYSHOHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.263/2023 i datës 29.11.2023, sa i përket cilësimit juridik të veprës penale ashtu që i akuzuari A. K. shpallet fajtor për veprën penale, Kanosja nga neni 181 par. 4 lidhur me par. 2 të KPRK-së, si dhe përkitazi me vendimin mbi dënimin, ashtu që të akuzuarit A. K. për veprën penale, Kanosja nga neni 181 par. 4 lidhur me par. 2 të KPRK-së, kjo gjykatë i shqipton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej një (1) vit e tre (3) muaj, ndërsa për veprën penale, Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve, nga neni 366 par. 1 të KPRK-së, i shqipton dënim me burg në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajve. Të

njëjtë i shqiptohet Dënim Unik me Burgim në kohëzgjatje prej një (1) vit e gjashtë (6) muaj, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Koha e kaluar nën masën e paraburgimit prej datës 21.06.2023 deri më 13.11.2023 do t'i llogaritet në dënimin e shqiptuar.

II. Ankesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të rënda refuzohet si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.263/2023 i datës 29.11.2023, për pjesën tjetër vërtetohet.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin PKR.nr.263/2023, të datës 29.11.2023, të akuzuarin A. K. e ka shpallur fajtor dhe e ka gjykuar:

Për veprën penale Kanosja nga neni 181 par. 4 të KPRK-së, me dënim me burgim në kohëzgjatje prej dy (2) vite, ndërsa për veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve, nga neni 366 par. 1 të KPRK-së, me dënim me burgim në kohëzgjatje prej tetë (8) muajsh. E në kuptim të nenit 362 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të KPRK-së, pasi që prokurori i shtetit është tërheq nga ndjekja penale është refuzuar akuza për veprën penale Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 356 par.1 të KPRK-së.

Komfor nenit 76 të KPRK-së, të akuzuarit A. K., i është shqiptuar dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej dy (2) vite e gjashtë (6) muaj i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Gjykata me aktvendim të posaçëm ka ndërprerë masën e paraburgimit për të akuzuarin e lartcekur, ndërsa koha e kaluar nën masën e paraburgimit nga data 21.06.2023 deri më datën 13.11.2023 do t'i llogaritet në dënimin e lartcekur.

Është konfiskuar Arma - “Zoraki 906-B”, “Made by Atak Arms LTD” me numër serik 0319, ndërsa i akuzuari është obliguar që në emër të shpenzimeve të procedurës, të paguaj paushallin gjyqësor në shumë prej njëqind Euro (100 €), ndërsa për programin për kompensimin e viktimave të krimit shumë prej pesëdhjetë Euro (50 €), të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Pala e dëmtuar Xh. Xh., ka hequr dorë nga kërkesa pasurore-juridike.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor kanë ushtruar ankesë:

Prokuroria Themelore në Prishtinë, Departamenti i Krimeve të Rënda, për shkak të vërtetimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike, për shkak të shkeljes së ligjit penal dhe për shkak të vendimit mbi sanksionin penal, i ka propozuar Gjykatës së Apelit që ta ndryshoj vendimin e Gjykatës së shkallës së parë, sa i përket vendimit mbi sanksionit penal, ashtu që të pandehurit t'i shqiptojë një dënim më të ashpër me burgim si dhe ta ri kualifikojë veprën penale ashtu siç ka qenë i akuzuar, për veprën penale Vrasje nga neni 172 lidhur me nenin 28 të KPRK-së, ose ta anuloj aktgjykimin dhe çështjen ta ktheje në rivendosje.

Mbrojtësi i të akuzuarit A. K., Av. Xhevdet Smakiqi për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal dhe shkeljes së ligjit penal. Gjykatës së Apelit i ka propozuar që vendimi mbi dënimin ndaj të akuzuarit A. K. të ndryshohet në një dënim më të butë sesa ajo e shqiptuar nga Gjykata e shkallës së parë apo që dënimi i njëjtë të kushtëzohet.

Prokuroria e Apelit me parashtrësën PPA/L.nr.18/2024, të datës 22.01.2024, Gjykatës së Apelit i ka propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Departamenti i Krimeve të Rënda, që Gjykata e Apelit që ta ndryshoj vendimin e Gjykatës së shkallës së parë, sa i përket vendimit mbi sanksionit penal, ashtu që të akuzuarit t'i shqiptojë një dënim më të ashpër me burgim si dhe ta ri kualifikojë veprën penale ashtu siç ka qenë i akuzuar, për veprën penale Vrasje nga neni 172 lidhur me nenin 28 të KPRK-së, ose ta anuloj aktgjykimin dhe çështjen ta kthejë në rivendosje, si dhe ta refuzojë si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të akuzuarit A. K., Av. Xhevdet Smakiqi.

Gjykata e Apelit caktoi dhe e mbajti seancën e kolegjit në pajtim me dispozitën e nenit 390 të KPPK-së me datë 16.01.2025, në të cilën seancë palët, ndonëse të njoftuar me kohë dhe në mënyrë të rregullt nuk prezantuan asnjëra në seancë.

Gjykata e Apelit pasi shqyrtoi shkresat e lëndës, studioi aktgjykimin e ankimuar komfor dispozitës së nenit 394 të KPPRK-së dhe pasi që vlerësoi pretendimet ankimore në ankesa, gjeti se:

Ankesa e mbrojtësit të akuzuarit A. K., Av. Xhevdet Smakiqi, është pjesërisht e bazuar, ndërsa ankesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Departamenti i Krimeve të Rënda është e pabazuar.

Pretendimet ankimore të Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Departamenti i Krimeve të Rënda.

Prokuroria e shtetit në ankesë pretendon se, Gjykata e shkallës së parë nuk ka vepruar drejtë kur e ka shpallur fajtor të pandehurin A. K. për veprën penale Kanosje nga neni 181 par. 4 e jo për veprën penale për të cilën është akuzuar, Vrasje në tentativë nga neni 172 lidhur me 28 të KPRK-së pasi që Gjykata në aktgjykimin e atakuar, gabimisht ka konstatuar gjendjen faktike e që kjo ka pasuar edhe me shkeljen e ligjit penal dhe vendimin mbi sanksionin penal, pasi që nga të gjitha provat materiale dhe personale të administruara në gjykatë, nuk është kontestuese se ditën kritike i pandehuri A. K. paraprakisht ishte fjalosur me të dëmtuarin - dëshmitarin Xh. Xh., derisa të njëjtit kishin qenë duke punuar në teren pasi kishin punuar në të njëjtën firmë, ku pas fjalosjes, përmes telefonit kishte ndërhyrë pronari i firmës - dëshmitari E. A. dhe të pandehurin A. K. e kishte larguar nga ekipi me qëllim të qetësimit të situatës duke e dërguar në ekip tjetër, mirëpo i pandehuri A. K., rrugës gjatë kthimit nga tereni, përmes telefonit kishte kërkuar armën dhe derisa udhëtonin me veturë, janë ndalur dhe një person i panjohur ia ka sjellë armën që ia kishte kërkuar i pandehuri përmes telefonit, ndërsa kur ishin kthyer në zyre, ku ishte pronari - dëshmitari E. A. dhe kolegu i tij - dëshmitari Z. K., pasi kishte arritur aty edhe i dëmtuari Xh. Xh., pas hyrjes së të cilit në zyre tek i pandehuri A. K. ishte shfaqur nervozizëm dhe me të vërejtur këtë, dëshmitari Enver Ademi kishte intervenuar duke i thënë të dëmtuarit Xh. që të del jashtë dhe derisa i dëmtuari Xh. Xh. kishte pranuar të del dhe derisa ishte duke dalë nga zyra, i pandehuri A. nxjerr armen nga brezi duke u munduar me shtënë në drejtim të të dëmtuarit, por vepra mbetet në tentativë sepse menjëherë ndërhyjnë dëshmitaret e lartcekur duke e kapur të pandehurin dhe duke u munduar t'ia marrin revolen, por për shkak të vendosmërisë së pandehurit për të kryer veprën penale, arrin të largohet prej tyre dhe me revole në dorë vazhdon ta ndjekë të dëmtuarin, i cili ndërkohë kishte ikur jashtë zyrës, ndërsa i pandehuri i afrohet dritares dhe tenton me shtënë në drejtim të vendit kah kishte ikur i dëmtuari, mirëpo arma fillimisht nuk i ka shkrep, kurse pas 5-6 sekondash i njëjti repeton armën dhe shtënë në drejtimin kah kishte ikur i dëmtuari Xh., i cili ndërkohë kishte ikur poshtë shkallëve në depo, ndërsa i pandehuri me këmbëngulësi dhe me armë në dorë e ndjek të dëmtuarin Xh. Xh. derisa aty del një punëtor dhe e pengon të pandehurin që të përfundojë veprën penale të Vrasjes në tentativë.

Sipas prokurorisë, në aktgjykimin e atakuar gjykata ka bërë edhe shkeljen e ligjit penal, sepse i pandehuri A. K. në asnjë mënyrë nuk ka pasur qëllim Kanosjen dhe nuk përmbushet asnjë element i figurës së veprës penale të Kanosjes, sepse në rastin konkret i pandehuri ka shtënë me

armë dhe në rastet kur kemi shkrepje të armës nuk mund të bëhet fjalë për veprën penale të Kanosjes, por nga rrjedha e ngjarjes dhe nga rrethanat e rastit duke përfshirë këtu shkrepjen e armës e pastaj ndjekjen e të dëmtuarit Xh. Xh. me armë në dorë në të cilën kishte edhe fishekë të tjerë në armë, përkundër përpjekjeve të mëdha të dëshmitareve të lartcekur për ta zmbarsur të pandehurin, përmbushen të gjitha elementet e veprës penale të Vrasjes në tentativë. Po ashtu, nuk është kontestuese, e që ceket edhe në aktgjykim (faqe 26 par 4, rreshti 5) se ditën kritike, pas fjalosjes së të pandehurit me të dëmtuarin derisa ishin në teren duke punuar, i pandehuri i ka thënë të dëmtuarit “sa të kthehem, kam me të la me gjak”, të cilin fakt Gjykata e ka marrë si rrethanë rënduese e që sipas Prokurorisë paraqet element të dashjes, me çka plotësohet figura e veprës penale të Vrasje në tentativë nga neni 172 lidhur me nenin 28 të KPRK-së.

Gjithashtu prokuroria konsideron se vendimi mbi sanksionin penal për të pandehurin është tejet i butë sepse gjykata nuk e ka marrë parasysh shkallën e lartë të dashjes, këmbëngulësisë dhe të paramendimit nga ana e të pandehurit dhe ky dënim nuk është në proporcion me peshën e veprave penale, nuk është në përputhshmëri me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të këtyre veprave penale dhe përgjegjësisë penale, duke konsideruar se me këto dënime nuk do të arrihet qëllimi i dënimit, i paraparë ne nenin 38 i KPRK-së.

Andaj, i ka propozuar Gjykatës së Apelit që ta ndryshoj vendimin e Gjykatës së shkallës së parë, sa i përket vendimit mbi sanksionit penal, ashtu që të pandehurit t'i shqiptojë një dënim më të ashpër me burgim dhe ta ri kualifikojë veprën penale siç ka qenë i akuzuar, Vrasje nga neni 172 lidhur me nenin 28 të KPRK-së, ose ta anuloj aktgjykimin dhe çështjen ta kthejë ne rivendosje.

Pretendimet ankimore të mbrojtësit të të akuzuarit A. K., Av. Xhevdet Smakiqi.

Mbrojtësi i të akuzuarit A. K. në ankesë pretendon se Gjykata e shkallës së parë ka shqiptuar dënim jo proporcional kur e ka caktuar lartësimi e dënimit unik me burgim efektivë prej 2 vite e gjashtë muajve ndaj të akuzuarit A. K., duke pasur parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese të përshkruara komfor nenit 71 të KPRK-së, mungesën e pasojave konkrete ndaj shëndetit fizik dhe mendor të dëmtuarit Xh. Xh., ky dënim është i pa precedent në praktikë gjyqësore, është shumë i lartë dhe se një dënim më i butë dhe i kushtëzuar me periudhë verifikimit prej 2 viteve maksimum do të ishte në pajtim të plotë me gjendjen faktike të vërtetuar dhe proporcionale me veprimet konkrete të mbrojturit tim A. K. si dhe në pajtim me praktiken për dënimet e shqiptuara në rastin e veprave penale Kanosje nga neni 181 të KPRK-së.

Mbrojtja konsideron se në këtë çështje juridike kanë ekzistuar dhe ekzistojnë rrethana veçanërisht lehtësuese të përshkruara si më lartë, edhe për faktin se për veprën penale të ri kualifikuar nga neni 181 të KPRK-së nga Gjykata e shkallës parë i akuzuari A. K. ka shprehur gatishmëri përmes mbrojtjes pranimit të fajësisë, por për shkak të refuzimit nga Prokurori i Shtetit iu ka mohuar kjo e drejtë ligjore e garantuar me dispozitat e KPPRK-së, me ç'rast gjykata ka bërë edhe shkelje të ligjit penal. Andaj i ka propozuar Gjykatës së Apelit që vendimi mbi dënimin ndaj të akuzuarit A. K. të ndryshohet me një dënim më të butë e të kushtëzuar, ose dënimi i shkallës së parë të kushtëzohet.

Vlerësimi i Gjykatës së Apelit

Edhe pse aktgjykimi i Gjykatës së shkallës së parë nuk është ankimuar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, Kolegji i gjykatës së Apelit të njëjtin lidhur me shkeljet e tilla e shqyrtoi sipas detyrës zyrtare dhe komfor nenit 394 par.1 të KPPK-së gjeti se i njëjti nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, e as shkelje të tjera të cilat detyrimisht do të kushtëzonin anulimin e tij.

Sa i përket pretendimeve ankimore të prokurorisë përkitazi me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, Kolegji i gjykatës së Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë, gjendjen faktike në këtë çështje penale e ka vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, për shkak se me provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor është vërtetuar se i akuzuari A. K. është kryerës i veprave penale për të cilat është shpallur fajtor nga gjykata e shkallës së parë.

Deri tek kjo gjendje faktike, gjykata e shkallës së parë ka ardhur pas administrimit të provave personale dhe materiale si: dëgjimi i të dëmtuarit në cilësi të dëshmitarit Xh. Xh., dëshmitarit E. A., dëshmitarit Z. K., Vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm i sendeve i datës 21.06.2023, Raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes i datës 21.06.2023, Lista e dëshmitarëve datë 21.06.2023, CD me video incizime nga vendi i ngjarjes, Foto albumi i datës 21.06.2023, mbrojtja e të akuzuarit A. K. si dhe shkresa të tjera të lëndës.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, vlerëson se gjykata e shkallës së parë, gjendjen faktike e ka vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë në këtë çështje penale, e të përshkruar si në dispozitivin e aktgjykimit, pasi që siç më të drejtë konstaton se, nuk ka qenë kontestuese fakti se me datën

21.06.2023 paraprakisht ka ndodhur një mosmarrëveshje në mes të akuzuarit A. K. dhe të dëmtuarit Xh. Xh., ku pas kthimit në punëtori gjatë bisedës që zhvillohej në zyrë mes të akuzuarit A. K. dhe dëshmitarëve E. A. dhe Z. K., pas 10-15 minutave me të hyrë në zyrë i dëmtuari Xh. Xh. ka filluar të acarohet situata dhe me atë rast i akuzuari A. kishte përdor armën, por që kontestuese ishte se cilat elemente të veprës penale përmbushen me rastin e ndërmarrjeve të veprimeve nga ana e të akuzuarit A. K.. E që nga provat e administruara gjatë shqyrtim gjyqësorë, në vlerësimin e këtij kolegji, gjykata e shkallës së parë drejt ka vepruar kur të akuzuarin A. K. e ka shpallur fajtor për veprën penale Kanosja nga neni 181 paragrafi 4 të KPRK-së.

Ashtu siç ka konstatuar edhe gjykata e shkallës së parë, se vepra penale e Kanosjes fillon me vet shprehjen e kanosjes që i akuzuari A. K. e ka shprehur me fjalët *“sa të kthehem ka me të la me gjak”*, ndërsa vepra penale kryhet kur kanosja objektivisht ka shkaktuar frikë apo ankth tek i kanosuri, e që në rastin konkret kolegji penal vlerëson se kjo vepër ka rezultuar të kryhet si vepër penale pasi që i dëmtuari Xh. Xh. në deklarin e tij në polici ka theksuar se *“atë ditë kam qenë i rrezikuar me jetë, po ashtu jam i shqetësuar vetë dhe të gjithë familjarët për këtë që ka ndodhur”*, ndërsa gjatë deklarin të tij në shqyrtim gjyqësorë ka deklaruar se *“po jam ndjerë i rrezikuar për jetën time dhe në aspektin fizik skam pasur ndonjë pasojë, por në aspektin psikik kam pasur shqetësim edhe unë por edhe familja ime”*.

Lidhur me pretendimin e prokurorisë se i akuzuari repeton armën dhe shtënë në drejtimin kah kishte ikur i dëmtuari Xh., poshtë shkallëve në depo dhe me këmbëngulësi me armë në dorë e ndjek të dëmtuarin Xh. Xh. derisa del një punëtor dhe e pengon që të përfundojë veprën penale të Vrasjes në tentativë, kolegji i gjykatës së Apelit vlerëson se është i pabazuar, ndërsa pajtohet me konstatimin e dhënë në aktgjykimin e shkallës së parë, ku sa i përket armës i dëmtuari është përgjigjur *“ashtu edhe siç thash në momentin që e kam parë që e ka nxjerr armën, unë kam dal e kam mbyllur derën dhe e kam dëgjuar krismën”*, se nuk ka mundur ta sheh të akuzuarin A. në momentin që ka shtënë me armë duke u përgjigjur *“dera ka një pjesë xhami në pjesën e sipërme i cili xham është i tejdukshëm mirëpo ka edhe roletna dhe besoj që nuk është dok”*, dhe pasi që ka dalur nga zyra ka ikur në drejtim të podrumit të frimës ku ka punuar dhe ska pasur asnjë kontakt me të akuzuarin A. deri sa ka ardh policia pas 15 minutave. Po ashtu nga CD videoincizimi i vendit të ngjarjes, prova materiale e administruar në shqyrtim gjyqësor shihet se duke nxjerrë armën i akuzuari A. , i dëmtuari veç se ka dalë nga zyra dhe se nuk ka mundur të shoh më tutje veprimet e të akuzuarit A. . Nga videoincizimet fillimisht shihet se në zyrë kanë qenë të pranishëm dëshmitari E. A., i akuzuari A. K. dhe dëshmitari Z. K., ku fillimisht i akuzuari

A. është i ulur pranë dëshmitarit E., ndërsa dëshmitari Z. gjendet në këmbë. Pas 10-15 minutave hynë në zyrë i dëmtuari Xh. Xh. i cili ulet në divan pranë dëshmitarit E. dhe situata fillon të acarohet sapo që i dëmtuari Xh. hyn në zyrë ku të njëjtit shihen vazhdimisht që janë duke komunikuar, e pastaj pas 20 sekondave i akuzuari A. ngrihet në këmbë e poashtu edhe dëshmitari E. ku shihet që bën me dorë nga i dëmtuari Xh. dhe nga i njëjti kërkon të dal nga zyrja, ku kjo pjesë gjenë mbështetje të plotë me deklaratat e dhëna përgjatë shqyrtimit gjyqësorë nga dëshmitarët E. A., Z. K., Xh. Xh. por edhe nga vetë i akuzuari A. . I akuzuari A. edhe pse është në këmbë nuk tenton që t'i afrohet të dëmtuarit Xh. por vetëm shihet duke biseduar me të njëjtin, ku me atë rast i dëmtuari Xh. ngritet nga divani për të dal në drejtim të derës. Situata shihet që është e tensionuar mes të akuzuarit A. dhe të dëmtuarit Xh. i cili është në dalje e sipër, ku pas disa sekondave shihet i akuzuari A. nxjerr armën nga brezi të cilën armë i njëjti nuk e kishte pasur të raportiratur, por të njëjtën e raportirat por nuk e tërheq këmbëzën dhe tenton ti afrohet dritarës të mbuluar me perde - trake dhe me tu afruar shihet që drejtimi i armës është gjithëherë në pjesën e poshtme të dritares dhe vërehet që arma nuk shkrep. I akuzuari A. kthehet me shpinë nga dëshmitari E. i cili gjendet i ulur në divan, armën e raportirat dhe sërish afrohet tek dritarja me perde trake, në të njëjtën kohë vërehet insistimi i dëshmitarëve E. dhe Z. që ta parandalojnë, por i akuzuari A. vërehet që e drejton armën në pjesën e poshtme të dritarës dhe me të njëjtën shkrep. Pas kësaj në video incizimet shihet se i akuzuari A. është duke biseduar me dëshmitarët E. dhe Z. dhe i pa penguar vazhdon të dal nga dera ku ka dal i dëmtuari Xh. dhe shkon në drejtim të koridorit që të shpie në podrum. Gjatë rrugës i pa penguar ai ndalohet nga një punëtor tjetër, ku me atë rast arrinë edhe dëshmitari Z. e pastaj edhe dëshmitari E., të cilët të akuzuarin A. e dërgojnë në zyrë dhe i njëjti ja dorëzon armën dëshmitarit E., i njëjti me rastin e daljes nga dera ka qenë i pa penguar, që ka përputhje të plotë edhe me deklarin e dëshmitarit Z. i cili në shqyrtim gjyqësorë ka deklaruar se “ndërsa kur ka dalur jasht në korridor A. i ka qenë i pa penguar, por Xh. ska qenë aty”.

Kolegji penal përkitazi me pretendimin ankimor të prokurorisë, se në rastet kur kemi shkrepje të armës nuk mund të bëhet fjalë për veprën penale të Kanosjes, për kolegjin penal të kësaj gjykate është i pabazuar ngase, KPRK ka përcaktuar se vepra penale e Kanosjes konsiderohet se është kryer kur “*Kushdo që seriozisht e kanos personin tjetër me fjalë, vepra apo gjeste se do t'i shkaktoj ndonjë të keqe me qëllim të frikësimit ose shkakimit të ankthit te personi i tillë*”, tutje paragrafi 2 i të njëjtës vepër përcakton se: “*Kushdo që seriozisht i kanoset personit tjetër me fjalë, vepra apo gjeste se do ta privojë nga jeta ose se do t'i shkaktojë lëndim të rëndë trupor, se do ta rrëmbejë ose privojë nga liria ndonjë person tjetër ose se do ta dëmtojë me armë zjarri,*

me shpërthim ose me mjete të tjera të rrezikshme, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit”, ndërsa paragrafi kualifikues paragrafi 4 ka përcaktuar se “kushdo që kryen veprë penale nga ky nen me përdorim të armës, mjetit të rrezikshëm ose ndonjë sendi tjetër me të cilin mund të shkaktohet lëndim trupor ose dëmtim i rëndë për shëndetin, dënohet me burgim prej 1 viti deri në 5 vjet”.

Nga kjo del se, për të ekzistuar vepra penale e Kanosjes nuk është doemos që veprimi i kryerësit të jetë me fjalë, por që kjo veprë penale mund të kryhet edhe me vepra apo gjeste, madje për më tepër paragrafi 4 i nenit 181 të KPRK-së, përdorimin e armës e ngërthen brenda vetes si element të kësaj vepre penale si rrethanë kualifikuese. Pra, paragrafi 1 dhe 2 i nenit 181, si paragrafë bazë të veprës penale Kanosja përcaktojnë se kjo veprë penale mund të kryhet edhe me vepra apo gjeste, ndërsa paragrafi kualifikues paragrafi 4 i nenit 181 parasheh se kjo veprë penale mund të kryhet edhe me përdorimin e armës si në situatën konkrete. Andaj, mbi bazën e të lartcekurave, kolegji i kësaj gjykate duke vepruar sipas detyrës zyrtare ka ndryshuar vetëm kualifikimin e veprës penale, Kanosja dhe atë, nga neni 181 par. 4 (siç ka vendosur gjykata e shkallës së parë), e që duke e ndërlidhur edhe me gjendjen faktike ka plotësuar kualifikimin e veprës penale duke shtuar edhe paragrafin 2 të nenit 181 të KPRK-së, si paragraf bazë që përshkruan veprimet e të akuzuarit A. K..

Përveç kësaj, prokuroria pretendon se me rastin kur i pandehuri i ka thënë të dëmtuarit “*sa të kthehem, kam me te la me gjak*”, sipas Prokurorisë në situatën konkrete paraqet element të dashjes, me çka plotësohet figura e veprës penale të Vrasje në tentativë nga neni 172 lidhur me nenin 28 të KPRK-së. Edhe ky pretendim për kolegjin e kësaj gjykate është i pabazuar, ngase në situatën konkrete një deklaram i tillë nga i akuzuari A. në drejtim të të dëmtuarit Xh. ka ndodhur para ngjarjes, konkretisht derisa ish-in në teren duke punuar, andaj në një situatë të tillë, i akuzuari A. vetëm se i ka shkaktuar ndjenjën e frikës dhe pasigurisë të dëmtuarit Xh., pa ndërmarr ndonjë veprim konkret në realizimin e asaj se çfarë ka thënë, e që një veprim i tillë ngërthen brenda vetes të gjitha elementet e veprës penale të Kanosjes nga neni 181 të KPRK-së.

Nga shkresat e lëndës rezulton faktin se i akuzuari A. ka paralajmëruar kanosjen ndaj të dëmtuarit e që vërtetohet edhe nga dëshmia e dëshmitarëve E. dhe Z., të cilët kanë deklaruar se i njëjti u ka thënë se do ta rrah dhe do t’ia thyej këmbët të dëmtuarit, pra gjatë gjithë kohës deklaramet e tij kanë qenë kërcënuese, por asnjëherë nuk ka pretenduar se të njëjtin do ta privoj nga jeta e as që ka ndërmarr ndonjë veprim në atë drejtim. Siç drejtë është specifikuar edhe nga

gjykata e shkallës së parë, se gjykata nuk mund të determinoj mendjen e të akuzuarit se çfarë ai ka menduar, por vullnetin dhe dashjen e tij për veprën penale e bazon në provat e administruara, pasi që gjykata aktgjykimin e vet e bazon vetëm në provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor ashtu siç e përcakton neni 360 paragrafi 1 dhe 2 i KPPRK-së dhe se në bazë të këtyre provave gjendja faktike të cilën gjykata e ka vërtetuar, nuk rezulton se i akuzuari ka ndërmarr veprime, qëllimi përfundimtar i të cilave ishte dashja që i akuzuari ta privon nga jeta tani të dëmtuarin, e që një qëndrim të tillë si të plotë, të drejtë dhe të ligjshëm e mbështet edhe kjo gjykatë.

Andaj, meqenëse aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe me gjendjen e vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, në këtë çështje penale gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e ankimuar nuk ka shkelur as ligjin penal siç pretendon prokuroria dhe mbrojtja në ankesë. Kjo për faktin se në veprimet e të akuzuarit përmbushen të gjitha elementet subjektive dhe objektive të veprave penale për të cilat i njëjti është shpallur fajtor, dhe se për këto vepra penale i njëjti është penalisht përgjegjës.

Duke shqyrtuar aktgjykimin e ankimuar përkitazi me vendimin mbi dënimin, Gjykata e Apelit, konstaton se pretendimet ankimore të mbrojtësit të akuzuarit A. K., Av. Xhevdet Smakiqi janë pjesërisht të bazuara, ndërsa pretendimet e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, janë të pabazuara.

Gjykata e shkallës së parë me rastin e caktimit të dënimit i ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësisë së dënimit në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së. Kolegji penal i kësaj gjykate vlerëson se Gjykata e shkallës së parë, gjatë matjes së dënimit pati parasysh të gjitha rrethanat e rastit konkret dhe si rrethanë lehtësuese morri parasysh shkollimin e tij i cili ka përfunduar vetëm shkollën fillore, pranimin e fajësisë përgjatë procedurës, të cilën i njëjti e ka shfaqur në të gjitha stadet e procedurës në deklarimin e tij në polici, prokurori dhe fjalën përfundimtare, pastaj pendesën e shprehur përgjatë gjithë procedurës, ku i njëjti si në deklaratën e dhënë në polici, prokurori dhe në fjalën përfundimtare ka shprehur pendesën dhe kërkuar falje të dëmtuarit dhe familjes së tij, e po ashtu gjykata ka marrë parasysh edhe pranimin e fajësisë për veprën penale të përshkruar në pikën II të dispozitivit të aktakuzës dhe ka shprehur pendesën përkitazi me veprimet e veta. Si rrethanë lehtësuese gjykata e shkallës së parë ka marrë për bazë edhe faktin se i akuzuari A. K. ka një të kaluar kriminale të pastër, i njëjti nuk dyshohet për ndonjë veprën penale dhe nuk ka ndonjë aktgjykim të formës së prerë. Ndërsa si rrethana rënduese, gjykata morri për bazë: shkollën e lartë të dashjes në kryerjen e veprës penale të kanosjes.

Një vlerësim të këtillë të rrethanave relevante për matjen e dënimit marrë parasysh rrethanat lehtësuese dhe pretendimet ankimore të mbrojtësit të akuzuarit, Gjykata e shkallës së parë nuk i ka dhënë vlerësimin e duhur rrethanave lehtësuese që shkojnë në favor të akuzuarit, ku i njëjti ka pranuar fajësinë për veprimet e veta si dhe pendesën e shprehur përgjatë procedurës, të cilën i njëjti e ka shfaqur në të gjitha stadet e procedurës si në deklarimin e tij në polici, prokurori dhe fjalën përfundimtare, ka shprehur pendesën dhe kërkuar falje të dëmtuarit dhe familjes së tij, e po ashtu edhe pranimin e fajësisë për veprën penale të përshkruar në pikën II të dispozitivit të aktakuzës pastaj fakti se i akuzuari A. K. ka një të kaluar kriminale të pastër, i njëjti nuk dyshohet për ndonjë veprë penale dhe nuk ka ndonjë aktgjykim të formës së prerë, rrethanat personale dhe sjelljen e kryesit pas kryerjes së veprës penale, e që sipas vlerësimit të kolegjit penal të kësaj gjykate japin bazë të mjaftueshme që arsyetojnë shqiptimin e dënimit nga kjo gjykatë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Prandaj, kjo Gjykatë vlerëson se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprave penale të kryera, me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe se kjo do t'i shërbej preventivës gjenerale, posaçërisht asaj individuale, forcimit të moralit të shoqërisë, si dhe përgjegjësisë dhe disiplinës së qytetarëve dhe se me këtë kryerësi do të parandalohet nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, si dhe do të bëhet rehabilitimi i tij. Andaj kolegji penal i kësaj gjykate konsideron se dënimi i shqiptuar është i mjaftueshëm për tu arritur qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitën e nenit 38 të KPRK-së.

Nga se u tha më lart, e në bazë të nenit 403 të KPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA

PAKR.nr.6/2024

Datë: 16.01.2025

Bashkëpunëtori Profesional

Anëtarët e kolegjit

Kryetar i kolegjit

Behar Haliti

Valbona Musliu Selimaj

Xhevdet Abazi

Numri i lëndës: 2023:140465
Datë: 11.02.2025
Numri i dokumentit: 06833177

Beqir Kalludra